

KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER SIGURIMIN NGA VJEDHJA

Neni 1

Përcaktime të përgjithshme

- 1.1 Kushtet e përgjithshme te kontrates për sigurimin nga vjedhja, këtu e më poshtë do të quhen “Kushtet e Sigurimit”.
- 1.2 Shoqëria e sigurimit ALBSIG SHA, këtu e në vazhdim do të quhet Siguruesi.
- 1.3 Personi fizik ose juridik, interesi pasuror dhe i ligjshëm i të cilit mbulohet sipas këtyre kushteve të Sigurimit këtu e më poshtë do të quhet “I Siguruari”.
- 1.4 Personi fizik, i cili nënshkruan kontratën dhe paguan primin e sigurimit në emër dhe për llogari të Siguarit këtu e më poshtë do të quhet “Kontraktuesi”.
- 1.5 Dëshmia për lidhjen e Kontratës së Sigurimit nga vjedhja këtu e më poshtë do të quhet “Polica e Sigurimit”.
- 1.6 Me vjedhje do të kuptohet tërësia e veprimeve me qëllim përfitimi të objektit/ëve të siguruar/a pas mbylljes se ambjentëve ku gjenden këto objekte, si dhe dëmet ndaj të njëjtave gjatë tentativës për kryerjen e saj, nëpërmjet:
 - a) dhunimit te mjeteve mbrojtëse te jashtme me anë të thyerjes, shqyerjes, përdorimit të çelsave, levave ose veglave të tjera të ngjashme me to.
 - b) rrugëve jo të zakonshme, që kërkojnë kalimin e pengesave ose të sistemeve mbrojtëse duke përdorur mjete artificiale të tjera ose aftësi të veçanta vetjake,të cilat rezultojnë me humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e objekteve të siguruara shoqëruar me lënien e gjurmëve, që mund të përdoren si provë.
- 1.7 Nëse të gjitha ose një pjesë e sendeve të siguruara janë të ruajtura me mjete mbrojtëse te veçanta në ambjentet e siguruara, ku ato ndodhen, vjedhja do të jetë e mbulueshme vetem nese autori i vjedhjes, pasi te jete futur ne ambjentet e brendshme, ka dhunuar mjetet mbrojtëse me nje prej mënyrave te permendura në pikën 1.6 (a. dhe b.).

Neni 2

Objekti i kontratës

- 2.1 Objekt i kontratës për sigurimin nga vjedhja është marrëdhënia kontraktore në të cilën Siguruesi ofron mbulimin e dëmeve të objekteve të siguruara nga vjedhja, kundrejt pagimit të primit dhe plotësimit të detyrimeve të kësaj kontrate nga i Siguruari.

Neni 3

Objektet e siguruara

Objekte të sigurueshme sipas kësaj kontrate sigurimi janë:

- 3.1 **Pajisje e sende shtepiace:** bashkesia e mobiljeve, pajisjeve e sendeve shtepiace.
- 3.2 **Pajisje zyre:** bashkesia e mobiljeve, pajisjeve, veglave e orendive, që përbëjnë pajimet normale te nje zyre, ose i shërbejnë përmbushjes normale së një veprimtarie tregtare apo profesionale si dhe instalimet e alarmit dhe të sigurisë, kasafortat, raftet e sigurimit te përforcuara, blloqet e kasetave të sigurimit (përfshijë përmbytjet përkatëse dhe ato të përcaktuara si mallra ose sende me vlerë).
- 3.3 **Makineri e pajisje teknologjike:** pajisje, makineri, impiante të levizshme, veglat dhe pjesët e ndërrimit e bazamentet përkatëse.
- 3.4 **Mallra:** mallra, lëndë të para, prodhime gjysëm të gatshme, lëndë rezervë dhe materiale konsumi, ambalazhe të brendshme e të jashtme, skarcot dhe mbetjet si dhe të tjera, që kanë afërsi me veprimtarinë e deklaruar, përjashtuar ato të përcaktuara si sende me vlerë dhe letra me vlerë.
- 3.5 **Objekte të vlefshme:** piktura, skulptura, objekte arti, që nuk janë mobilje, peliçe, objekte argjendi, tapete e sixhade, përjashtuar ato të përcaktuara si sende me vlerë dhe letra me vlerë.
- 3.6 **Sende me vlerë:** gurë dhe metale të çmuara (ar e platin) të përpunuara ose jo, objekte me metale të vlefshme e perla natyrale.
- 3.7 **Letra me vlerë:** kartmonedha, tituj krediti, obligacioni e lloje të tjera të mjeteve të pagesës të tregtueshëm.

Neni 4

Përfshijë nga mbulimi

- 4.1 Sigurimi nga vjedhja nuk mbulon dëmtimet apo humbjet që shkaktohen drejtpërsëdrejti apo indirekt prej:
 - 4.1.1. Shpërdorimit, përvetësimit, falsifikimit, mashtrimit apo nga pakujdesia e rëndë e të Siguarit, pjesëtarëve të familjes ose punonjësve të tij,
 - 4.1.2. Humbjeve të pashpjegueshme, zhdukjeve misterioze, mungesave në inventar, mungesave të shkaktuara nga gabimet në veprimet kontabël ose nga numërimi gjatë inventarit,
 - 4.1.3. Vjedhjes së thjeshtë, vjedhjes nga klientët, vjedhjes me mashtrim etj,
 - 4.1.4. Vjedhjes nëpërmjet përdorimit te dhunës fizike ose psiqike, përveç rastit të përdorimit të të njëjtave kundër rojeve,
 - 4.1.5. Manipulimit ose keqpërdorimit te pajisjeve elektronike të përpunimit të të dhënave,
 - 4.1.6. Zjarrit, eksplozionit ose çarjes se tubacioneve te ujit dhe ne se nje gje e tille ndodh si rrjedhoje e vjedhjes,
 - 4.1.7. Tërmetit, stuhive, shpërthimeve vullkanike, përmytjeve, ndotjeve radioaktive e shpërthimit bërthamor,
 - 4.1.8. Veprimeve luftarake të çdo lloji pavarsisht nëse lufta është shpallur ose jo (përfshirë luftën civile), gjendjes së jashtëzakonshme, anarkisë, mosfunksionimit të shtetit (qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit), grushteve të shtetit, terrorizmit, sabotimit, revoltave, kryengritjeve, grevave, trazirave popullore, turbullirave civile, eksodeve, konfiskimeve, rekuizimeve, shkatërrimeve apo dëmtimeve të kryera me urdhër të çfarëdolloj qeverie apo autoriteti shtetëror.
- 4.2. Siguruesi nuk mbulon dëme që shkaktohen, nxiten ose ndihmohen me qëllim e faj nga:
 - 4.2.1. persona, që banojnë me të Siguarin dhe zënë ambjentet ku ndodhen sendet e siguruara ose lokalet e banesat me të cilat komunikojnë;
 - 4.2.2. vartësit e të Siguarit.
 - 4.2.3. të ngarkuarit me mbikqyrjen e sendeve të siguruara, lokaleve ose banesë ku ndodhen këto objekte.
 - 4.2.4. personat e lidhur me të Siguarin me lidhje farefisnore ose krushqie edhe në qoftë se nuk bashkëjetojnë.

Neni 5

Afatet e kontratës

- 5.1 Kontrata e sigurimit (Polica) lidhet ne baze te kerkeses me shkrim te te Siguarit. Siguruesi lëshon policen e sigurimit kundrejt pagesës së primit të sigurimit përcaktuar në bazë të njoftimeve dhe deklarimeve të bëra nga i Siguruari. Kërkesa, njoftime dhe deklarime të tjera të të Siguarit i bashkëngjiten Kontratës së sigurimit dhe janë pjesë e saj.
- 5.2 Afati i vlefshmërisë të kontratës fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar në policësi si ditë e fillimit të mbulimit dhe përfundon në orën 24.00 të ditës të përcaktuar si ditë e përfundimit të saj, me kushte qe primi i sigurimit te jete paguar.
- 5.3 Afati i vlefshmërisë të kësaj kontrate është si rregull një vit përveç, kur në Policën e sigurimit përcaktohet ndryshe, por jo më pak se tre muaj përjashtuar në raste të tilla si ekspozita, panaire etj.

Neni 6

Territori i vlefshmërisë së kontratës

Kjo kontratë mbulon nga rreziku i vjedhjes interesa pasurorë të personit fizik me vendbanim ose të personit juridik (qendër, degë, filial, përfaqësi) me seli në Republikën e Shqipërisë mbi sende ose pasuri që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Primi i sigurimit, përlllogaritja dhe pagesa e tij, efektet e mospagesës, kthimi i primit

- 7.1 Primi i sigurimit është produkt i tarifës bazë dhe disa fakteve që karakterizojnë objektin e siguruar, të shprehura në koeficientë.
- 7.2 Pagesa e primit të sigurimit bëhet në monedhën e përcaktuar në të pranë degës lëshuese të policës së sigurimit dhe quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit.
- 7.3 Primi i sigurimit mund të paguhet tërësisht ose me këste. Kur primi i sigurimit paguhet me këste; numri, vlera nominale e secilit këst dhe datat e maturimit të tyre, përcaktohen nga palët, dhe shënohen në Policën e Sigurimit, por kësti i fundit duhet të paguhet jo më vonë se 3 muaj nga data e mbarimit të afatit të policës së sigurimit.

- 7.4 Kur i Siguruar nuk paguan primet (këstet) në vazhdim sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet në ora 24.00. të ditës së pesëmbëdhjetë, duke filluar nga data e maturimit të këstit të rradhës të papaguar, dhe Siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Kontratës së Sigurimit. Humbjet dhe dëmtimet e vertetuara brenda afatit të mësipërm dëmshpërblehen vetëm pasi të jetë zbritur shuma e papaguar e primit të sigurimit, ndërsa humbjet dhe dëmtimet e vertetuara pas ditës së pesëmbëdhjetë nga data e maturimit të këstit të papaguar janë të pambulueshme.
- 7.5 Mospagimi në kohë i çdo kësti, sipas përcaktimeve në policë, sjell si pasojë zgjidhjen e kontratës së sigurimit, pa detyruar Siguruesin të bëjë njoftim të veçantë të Siguruarit, përveç njoftimit të bërë atij, për t'i kujtuar detyrimin për të paguar në kohën e përcaktuar në police dhe Kushtet e Përgjithshme.
- 7.6 Kur pasuria e siguruar transferohet (kalon në pronësinë e një të treti), kontrata e sigurimit zgjidhet automatikisht. Në këtë rast primi i pafitur i kthehet të Siguruarit.
- 7.7 Primi i sigurimit kthehet në vendin e lëshimit të policës pasi është mbajtur nga Siguruesi vlera e shpenzimeve përkatëse. Primi nuk kthehet nëse:
- a- i Siguruar ka përfitur ose pritet të përfitojë dëmshpërblim nga Siguruesi,
 - b- kur primi i pafitur është jo më shumë se 10% e primit të shkruar.

Neni 8

Shuma e siguruar dhe vlera e objektit të sigurimit

- 8.1 Shuma e siguruar e shënuar në policë është kufiri maksimal i përgjegjësisë të Siguruesit, me vertetimin e rastit të sigurimit. Shuma e siguruar e çdo objekti përcaktohet në bazë të kritereve për përcaktimin e vlerës së tij.
- 8.2 Vlera e objekteve të siguruar do të përlllogaritet bazuar në gjendjen faktike të çdo objekti, në përputhje me njërin nga përcaktimet e përshkruara më poshtë (si vlera e zëvendësimit, aktuale e tregut):
- **Për pajisje dhe sende shtëpiake, vlera e zëvendësimit,** që do të konsiderohet vlera për tu paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të të njëjtit tip dhe cilësi në një gjendje si të reja cilado qoftë shuma më e ulët;
 - **Për pajisjet e zyrës:**
 - a) *vlera e zëvendësimit;*
 - b) *vlera aktuale,* e cila përcaktohet nga vlera e tyre e zëvendësimit minus një zbritje në përputhje me gjendjen fizike të tyre (shkalla e amortizimit).
 - **Për Makineritë dhe pajisjet teknologjike:**
 - a) *vlera e zëvendësimit;*
 - b) *vlera e tregut,* e cila do të zbatohet për të gjitha makineritë dhe pajisjet, që kanë më shumë se 7 vjet shfrytëzimi në punë si të reja, dhe ekziston tregu për shitjen e të njëjtave, në tip, karakteristika dhe parametra të tjerë. Kjo vlerë do të orientohet nga çmimi i atij tregu. Në çdo rast tjetër, vlera e makinerive dhe pajisjeve nuk do të kalojë 20%, të vlerës së tyre të zëvendësimit.
 - **Për mallra, lëndë e parë dhe produkte gjysëm të gatshme vlera e zëvendësimit:**
 - a) *malli,* që nënkupton vlerën e produktin të përfunduar, të gatshëm për tu shitur, e cila përmbledh në vlerën për njësi të tij, të gjitha shumat e akumuluar për prodhimin e tij ose strukturën e kostos, si vlerën e lëndës së parë, të lëndëve ndihmëse, punën e materializuar, ambalazhin, etj. kosto që shoqërojnë të gjitha proceset e prodhimit të produktit, deri në sistemin e tij në vendin e përhershëm.
 - b) *Lënda e parë,* që nënkupton vlerën totale të shpenzimeve (kostot) e mbërritjes së tyre në magazinën e prodhuesit.
 - c) *Produkte gjysëm të gatshme,* që nënkupton koston e lëndëve të para dhe ndihmëse, plus punën e materializuar, deri në sjelljen e tyre në gjendjen e dhënë (produkt i pa përfunduar).
 - **Për objektet e vlefshme dhe sendet me vlerë, vlera e zëvendësimit.**
 - **Për letrat me vlerë,** përveç kartmonedha, *vlera e zëvendësimit,* që në këtë rast nënkupton se detyrimi i vetëm i Siguruesit është kompensimi i kostos së lëshimit të dublikatave të tyre, nëse kjo lejohet me ligj.

Kartmonedhat do të sigurohen vetëm deri në një shumë të caktuar, të rënë dakord me palëve dhe së bashku me sendet me vlerë duhet të mbahen në kasafortë.

- 8.3 Nuk do të mbulohen në sigurim vlerat e rralla historike.
- 8.4 Në rast të sigurimit “në bazë të rrezikut të parë”, që do të deklarohet shprehimisht në policën e sigurimit, shuma e siguruar do të përfaqësojë një pjesë të vlerës së plotë dhe Siguruesi do të paguajë në çdo rast dëmi deri në këtë shumë të siguruar, duke mos zbatuar kushtin e nënsigurimit.
- Primi i sigurimit do të jetë më i lartë nga ai i llogaritur për sigurimin në bazë të vlerës së plotë.

Neni 9

Pjesa e zbritshme

- 9.1 Në policat e sigurimit të pasurisë nga vjedhja, si rregull do të aplikohet pjesë e zbritshme dhe franshizë.
- 9.2 Siguruesi nuk do të trajtojë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në Policën e Sigurimit.
- 9.3 Për çdo rast dëmi të trajtueshëm, Siguruesi do të zbrisë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit, si përqindje mbi çdo një dëm ose seri dëmsh, të shkaktuara nga një ngjarje e vetme sigurimi.
- Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizes përcaktohen në Policën e Sigurimit.

Neni 10

Detyrimet e të Siguruarit

I Siguruar detyrohet:

- 10.1 në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit, duhet të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat janë thelbësore, nëse ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë, në atë kontratë. Nëse i Siguruarit me qëllim nuk e permbush ketë detyrim, Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë primin e sigurimit, shumën e sigurimit si dhe të zgjidhë kontratën e sigurimit;
- 10.2 të zbatojë masat e rregullat e sigurimit, rregullat e rekomandimet e Siguruesit si dhe të tregojë përkujdesjen e duhur për parandalimin e dëmit;
- 10.3 të regjistrojë mallin, sendet e letrat me vlerë dhe dokumenta të tjerë, përveçse në banesa;
- 10.4 të ruajë dhe të mbajë në gjendje pune të gjitha pajisjet e sigurimit, që kanë ekzistuar në kohën, që është bërë kërkesa për sigurim ose për të cilat është rënë dakord për t'u pajisur më vonë, në veçanti sistemin e alarmit.
- 10.5 të mbajë në kasafortë, objektet e vlefshme, sendet dhe letrat me vlerë dhe dokumenta të tjera në përputhje me nivelin e sigurisë të përcaktuar nga Siguruesi. Nëse për arsye organizimi kjo gjë nuk është e mundur, të lajmërojë Siguruesin menjëherë, me shkrim.
- 10.6 në rast të transferimit (lëvizjes) të sendeve të siguruar, për çfarëdo arsye, të njoftojë Siguruesin të paktën 10 ditë përpara këtij transferimi. Nëse i Siguruarit nuk përmbush në kohën e duhur këtë detyrim, mbulimi në sigurim quhet i pezulluar nga ora 24.00. e ditës së mëparshme të transferimit dhe hyn përsëri në fuqi në orën 24.00. të ditës së dhjetë nga dita në të cilën Siguruesi ka marrë njoftim.
- 10.7 pas plotësimit të kërkesës për sigurim të mos kryejë ose lejojë ndryshime, që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin të Siguruesit, si dhe të informojë menjëherë me shkrim Siguruesin për çdo shtim të rrezikut të mëvonshëm për të cilin vihet në dijeni, edhe nëse një shtim i tillë ndodh pa pëlqimin e tij. Në rast të mosnjoftimit të Siguruesit, ky i fundit çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

Neni 11

Shtimi i rrezikut

Me shtim të rrezikut kuptohen rastet kur:

- mjetet e sigurimit që ekzistonin në kohën e përpilimit të kërkesës së sigurimit apo të përcaktuara në policën e sigurimit janë pakësuar në numër, janë zvogëluar në përmasa apo iu është pakësuar efektiviteti;
- pasi ka humbur qoftë edhe vetëm një kopje e një çelësi për hyrjen në ambjentin ku ndodhen objektet e siguruar dhe çelësi, dryni apo brava nuk janë zëvendësuar me një tjetër set;

- në godinën ku ndodhen objektet e siguruar kryhen punime ndërtimi ose riparimi dhe/ose në ndërtesën ngjitur me të janë vendosur vinça ose pajisje të një natyre të ngjashme (skela etj.);
- dhomat, që kufizojnë ambientin ku ndodhen objektet e siguruar nga lart, poshtë apo anash rrinë përherë apo përkohësisht bosh;
- në njësinë ekonomike ndërpritet për më shumë se 3 ditë të njëpasnjëshme veprimtaria normale ku ndodhen objektet e siguruar;
- banesa lihet për më shumë se 21 ditë të njëpasnjëshme pa mbikqyrje.

Neni 12

Dëmshpërblimi, procedura, detyrime të palëve

- 12.1 Në rast dëmi mbi objektet e siguruar **i Siguruari** duhet:
- të njoftojë menjëherë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e rastit të sigurimit dhe vlerën e përafërt të dëmit. "Menjëherë" sipas kësaj kontrate konsiderohet njoftimi brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes së rastit ose vënies në dijeni të tij.
 - të kryejë denoncimin pranë organeve kompetente;
 - t'i paraqesë Siguruesit brenda 3 ditëve nga ndodhja e rastit të sigurimit ose vënies në dijeni të tij, një listë të plotë e të specifikuar të sendeve të vjedhura apo të dëmtuara me vlerat përkatëse, si dhe një kopje të denoncimit të kryer pranë organeve kompetente;
 - të bllokojë librat e llogarisë dhe dëshmi të tjera të pasurisë së tij;
 - të marrë masa të menjëhershme për kthimin e sendeve të vjedhura dhe për ruajtjen e atyre të mbetura edhe pse të dëmtuara.
 - të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim, e cila të përmbajë emrin e të Siguararit, numrin dhe datën e policës së sigurimit dhe vlerën e dëmshpërblimit të kërkuar.
 - të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Siguruesi për trajtimin e dëmit.
 - nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos dëmshpërblyer në bazë të këtyre kushteve të sigurimit, i Siguruari do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi i pësuar nuk është pasojë direkte ose indirekte e përjashtimeve.
- 12.2 Në rast dëmi mbi objektet e siguruar **Siguruesi** duhet:
- brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për rastin e sigurimit të fillojë ekspertimin e rastit;
 - të paguajë dëmshpërblimin në bazë të ekspertimit përfundimtar dhe kërkesës për dëmshpërblim të të Siguararit ose ta refuzojë atë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së dokumentit të fundit të kërkuar për trajtimin e plotë të rastit të sigurimit.
- 12.3 Siguruesi ka të drejtë të shtyjë pagesën e dëmshpërblimit:
- për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguararit për t'u dëmshpërblyer;
 - në qoftë se ka filluar çështje penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj të Siguararit ose njërit prej përfaqësuesve të palës së tij (sipas Neni 4, pika 4.2) deri në përfundimin e një procedure të tillë;
 - për aq kohë sa i Siguruari nuk paraqet dhe nuk plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi;
- 12.4 Vlera e dëmshpërblimit përcaktohet në përputhje me përcaktimet e shumës së siguruar (Neni 8, i Kushteve të Përgjithshme).
- 12.4.1 në rast të humbjes totale (vjedhjes) të objektit të siguruar, Siguruesi do të dëmshpërblejë vlerën përkatëse të tyre në momentin para ndodhjes së rastit të sigurimit.
- 12.4.2 në rast dëmi të pjesshëm (dëmtim të objektit të siguruar shkaktuar nga tentativa e vjedhjes), Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet e nevojshme, që duhet të bëhen për restaurimin e vlerës përkatëse të objekteve në momentin para ndodhjes së rastit të sigurimit.
- 12.5 Paga e dëmshpërblimit bëhet në monedhën e përcaktuar në policën e sigurimit.
- 12.6 Në qoftë se Siguruesi ka paguar dëmshpërblim të plotë për sendin/et e siguruar/a, ato automatikisht bëhen pronë e Siguruesit.

- 12.7 Në qoftë se objektet e siguruar të vjedhura janë zbuluar pas pagesës së dëmshpërblimit i Siguruari ka të drejtë që përkundrejt rimbursimit të dëmshpërblimit Siguruesit t'i marrë ato. Në të kundërt ato mbeten pronë e Siguruesit.

Neni 13

Çlirimi nga detyrimi i Siguruesit

- 13.1 Kur i Siguruari për qëllime përfitimi të padrejtë zmadhon vlerën e dëmit, deklaron të jenë vjedhur sende që nuk ekzistojnë në momentin ngjarjes së sigurimit, fsheh sende të pavjedhura, krijon dokumenta të rreme, ndryshon me qëllim gjurmët e provat materiale të krimit, Siguruesi çlirohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer.
- 13.2 Nuk do të mbulohet fitimi i munguar dhe dëmet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tillë si, dëmet për shkak të vonësive, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobat etj.
- 13.3 Nëse i Siguruari nuk arrin të plotësojë kushtet e përcaktuara në këtë kontratë për parandalimin dhe zvogëlimin e dëmit, Siguruesi, brenda një muaji nga dita që ka marrë dijeni, mund të zgjidhë kontratën e sigurimit duke e njoftuar të Siguararin me shkrim. Siguruesi do të lirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit, nëse shkak i ndodhjes së rastit të sigurimit është mosplotësimi i detyrimeve me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguararit.
- 13.4 Brenda 60 ditëve nga zgjidhja e çdo kërkesë për dëmshpërblim, panvarësisht nga natyra e kësaj zgjidhjeje, Siguruesi mund të shfuqizojë kontratën e sigurimit duke njoftuar me shkrim 30 ditë më parë të Siguararin.

Neni 14

Sigurime të tjera

- 14.1 Nëse i Siguruari kryen sigurime të tjera, kundrejt të njejtit rrezik të siguruar për mbulimin e objekteve pasurore si në këtë kontratë, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin, për emrin/at e Siguruesit/ve të tjerë dhe shumën/at e siguruar.
- Kur i Siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, Siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shpërblimin e dëmit.
- 14.2 Masa e dëmshpërblimit që perfiton i Siguruari nga të gjitha policat në fuqi, nuk mund të jetë më e lartë se masa e dëmit, minus pjesën e zbritshme më të lartë të përcaktuar ndër këto polica.
- 14.3 Nëse i Siguruari kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

Neni 15

Mbisigurimi

- 15.1 Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën e objektit të siguruar, atëherë si Siguruesi ashtu edhe i Siguruari mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar, dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht. Në çdo rast i Siguruari nuk mund të perfitojë dëmshpërblim në vlerë më të madhe se humbja e pësuar nga ngjarja e sigurimit, cilado qoftë shuma e siguruar e shënuar në policën e sigurimit.
- 15.2 Nëse i Siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

Neni 16

Nënsigurimi

Nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e objektit të siguruar, dëmshpërblimi i llogaritur do të zvogëlohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së objektit të sigurimit.

Neni 17

Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjes, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.